

## SI PO RRËHET ME ANË TË MITEVE

Mbas publikimit të artikullit a të sprovës ‘Dritëhije në histori (Martin Camaj e Ernest Koliqi, të pazbuluar)’, i cili ka pasë një titull fillestar ‘Mite të rreme’ (5 korrik 2020, *Peizazhe të fjalës*), erdhi reagimi i parë me shkrimin ‘Kur mitet përfliten’<sup>1</sup> (6 korrik, *Shqiptarja.com* etc). Ky shkrim hapi debatin dhe dinamikën e diskutimit, e cila vijon të jetë aktuale. Natyrisht, autori i shkrimit, z. Auron Tare, e ka kthye në ritual angazhimit e tij në intervista dhe debate, të cilat për fatin e keq, ngjajnë një RPT e asaj dosje’ që ka publikue, pa nxjerrë asnjë element shtesë të materialit (pjesës tjetër) që ka në proces, simbas pohimeve të tij.

Ndërkohë, ndokënd që priste Akademinë e Shkencave të Shqipërisë që të fliste mbi këtë debat, përgjigjja erdh në datën 9 korrik 2020. Në qëndrimin e saj Akademia, pohoi ‘*se ky debat nuk ka të bëjë me vlerat dhe kontributet letrare dhe shkencore të personaliteteve për të cilët diskutohet*’, e ndërkaq kontributin e Camajt e vlerësoi me një citim të Ismail Kadaresë. Për Koliqin, nuk kishte ndonjë citim nga Kadareja! Si përfundim, me sa u kuptue Akademia e la të hapun dhe të mirëpritun debatin, jashtë dyerve të saj. Gja që parashihej me ndodhë, kur studiues e monografistë të Camajt e Koliqit, deklaruen (me za a me heshtje), se nuk janë për reagime jashtëletrare. Pra, u vû re se një reagim civil e profesional, prej disave, qoftë edhe atëherë kur konvencioni nuk asht direkt letrar, në atmosferën shqiptare deri tash mungoi. Por nuk munguen raste, që reagimet e profesionistëve degraduen në analiza të rëndomta mediatike, apo qëndrime fyese e ofensive, prej të cilave ne jemi distancue dhe vidojmë të distancohemi. Sigurisht, jemi për një debat konstruktiv, ku të përfshihen të gjithë specialistët e fushave, historianë, arkivistë etc., që me ndërtue një kritikë të shëndoshtë. E kundërta asht regresion kulturor, e mosvlerësim i debatit.

Me aq sa na lejonte formimi ynë prej historianësh, tue pasë parasysh dosjen e sjellë nga z. Tare, si edhe qëndrimet e tij, pikëzue disa çështje, që sot specialistë të fushës i kanë zberthye ma mirë, tue u mbështetë në fakte

---

<sup>1</sup> Lisandri & Aristeia Kola, ‘Kur mitet përfliten’, *Shqiptarja.com* etc.

dhe kundërargumente. Segmentimi i dokumenteve apo i njisive/faksimileve del se asht një element i kritikueshëm i z. Tares, sikurse e kemi pohue: ‘Shpesh mungojnë faksimilet, e në vend të tyre janë përkthime a përshtatje, prej burimeve, njisive origjinale.’ Dosjet e ekzilantëve shqiptarë, nëpër shërbime të ndryshme të inteligjencës asht kahmot e ditun se janë dhe janë ba objekt shqyrtimi. Burimet ma të shpeshta që z. Tare sjellë, janë prej fondit të deklasifikuem të CIA-s, i cili duhet drejtpeshue në gjykim. Tue pá mënyrën e punës së z. Tares dhe rrugës së dallashtë metodologjike, theksuem se: ‘ajo që të ban përshtypje në analizën e materialeve që vën në dispozicion z. Tare, asht **mungesa e relativizimit** të landës dokumentative. Edhe pse të gjenduna në fondin e aksesueshëm (masivisht) të CIA-s, ato dokumente për motive historike dhe distancë në sigurimin e informacionit, asht e mira të relativizohen sot dhe të adresohen ma me ftohtësi.’ Tash njëherësh, kanë folë specialistë e kompetentë të fushës, të cilët kanë vû në dukje se: ‘Akuzat ndaj Koliqit dhe Camajt nuk bazohen mbi veprime konkrete të tyre, nuk bazohen mbi fakte të asaj që ata kanë bërë apo thënë; secila është ngritur nisur nga një dokument i vetëm i shërbimeve sekrete, me informacion indirekt, të hamendësuar, pa fakte apo prova për veprimtari informimi ndaj agjenturave nga Koliqi dhe Camaj’.<sup>2</sup> Po ajo çka pohon si ma të randësishme studiuesi Kapri në fjalë asht se: ‘Historianët kanë paralajmëruar se, përveç domosdoshmërisë së hulumtimit metodik të së kaluarës, trajtimi i informacionit të shërbimeve sekrete duhet bërë me shumë kujdes: këto informacione nuk janë të besueshme, veçanërisht raportimet e informatorëve sekretë, të cilët shpesh gënjejnë apo japin informacione të pasakta. (Vetë CIA ka deklaruar se nuk garanton dhe nuk mban përgjegjësi për vërtetësinë e informacioneve operative që ka deklasifikuar).<sup>3</sup> Implikime apo ‘kryqëzime’ dokumentative të z. Tares, kanë çue studiues në përfundimin se: ‘Asnjë dokument nuk disponohet nga autori, se Camaj në Jugosllavi ushtronte aktivitet për llogari të UDB-së, ose se largimi i tij nga Jugosllavia ishte i lidhur me një mision të ngarkuar nga ky shërbim në mërgatën shqiptare në Romë apo në Mynih.’<sup>4</sup> Asht i njohun fakti, ndërkohë, se studiues si Kastriot Dervishi, kanë kthjellue për planet e ish-Sigurimit të Shtetit në lidhje me Martin Camajn mbas arratisjes: ‘Për këtë ata mendonin “ta digjnin para zbulimit amerikan” nëpërmjet një kombinacioni. Për këtë mendohej në planin e datës 4. 11. 1965 të dërgoheshin disa letra nga Shqipëria në Itali ku disa persona të përhapnin opinione negative, sikur ishte çuar [M.C., sqarimi ynë] nga Sigurimi, etj. Madje në një nga letrat që do i shkruanin “antikomunistët”, këta do

<sup>2</sup> Erald Kapri, *exit.al* (10 korrik 2020).

<sup>3</sup> *ibid.*

<sup>4</sup> Romeo Gurakuqi, ‘Metoda e kërkimit dhe analizat e një Mohësi’, *Mapo*, 11 korrik 2020.

ta kërkonin ta vrisnin si “i dërguari nga Sigurimi”. Këtu do të shfrytëzohej fakti se Camaj u kish thënë disa miqve vetë atë që i kish bërë Sigurimi. Për këtë deklaratë që Camaj i kish nënshkruar Sigurimit, do shpërndahej në fotokopje.<sup>5</sup> Këtë fakt, z. Tare nuk e përmend askund, paçka se në njëfarë mënyrë ‘e amnistion’ si të panjollë Camajn për firmosjen e bashkëpunimit me ish-Sigurimin. Ngjanë, në krahun tjetër, ma qesharak edhe një copëz shkrimi (e sjellë si faksimile segmentale, por që mungojnë shumë komponentë të njisisë origjinale) nga z. Tare, që pretendon me e ba të ‘përlyem’ Camajn në deponimin për ish mësuesit e tij jezuitë, ndërsa ata ishin pushkatue në 1946 e deponimi i Camajt u krye në 1948. Pra si mund të jetë akuzë një gja e tillë, përpos se sajim operativësh? Besueshmëninë për vërtetësinë e shkresës e vën në pikëpyetje Bardhyl Demiraj, me një logjikë tepër të thjeshtë të analizës së letrës: *‘Lejohem të shtoj vetëm se kush është në gjendje të lexojë faksimilen e deklaratës së firmosur prej Martin Camajt dhe ka ndopak idenë e gjuhës dhe të stilit të tij, mëson shumë lehtë se Camaj është thjesht personi që pas gjase është detyruar vetëm të firmosë pas pesë ditësh arresti një shkresë të gatshme në dialektin tosk. E theksoj jo vetëm në dialektin tosk, por sidomos pas pesë ditësh, me kuptuar lehtë rrethin “e dhjetë” të ferrit që mund a duhet të ketë përjetuar edhe i riu 22/23-vjeçar Martin Camaj.*<sup>6</sup> Sa i takon dosjes së Camajt, deri në këto momente, rezultati i paraqitjes së sprovës së z. Tares, dhe kontestimi publik në shtyp e ekran, ka shty kreun e AIDSSH, znj. Gentiana Sula (më datë 10 korrik 2020, urdhër 31) me marrë një hetim përputhshmënie të dosjes fizike (fashikull nr. 456) dhe asaj digjitale. Mbi teknikalitetin dhe interpretimin e dosjes Camaj, u shpreh edhe Gurakuqi: *‘Deklaroj me përgjegjësi publike se, Dosja e Martin Camaj është një Dosje Personi nën Hetim me datën 5 maj 1948, që vijon me 10 maj me një deklaratë aderimi si bashkëpunëtorë, por duke qenë se Martin Camaj sapo del nga Dega e Punëve të Brendshme Shkodër, përgatit dhe realizon ikjen brenda 3 muajsh, kjo dosje, nga 9 korriku 1948 shndërrohet në një dosje të një elementi armik.’* Detaje e sqarime të tjera, priten të mësohen, mbasi z. Tare nuk ka dhanë shpjegime të tjera në lidhje me konsiderimin e dosjes Camaj, apo modalitete të tjera përpunimi.

Sikundërse e ka pohue sa herash vetë, gjatë intervistave, z. Tare nuk njeh asnjë vepër të Martin Camajt, por kjo nuk e ka pengue me vù në pikëpyetje tagrin e Ministrive të Kulturës (Shqipëri-Kosovë) për me organizue konferenca në nder të Camajt dhe Koliqit, por as me ba ndonji

<sup>5</sup> Kastriot Dervishi, ‘1965/Sigurimi: “Martin Camajn e duan...’, ribot. 55 news.al, 9 korrik 2020.

<sup>6</sup> Bardhyl Demiraj, intervistë, *Panorama*, 10 korrik 2020.

epilog (edhe pse të qortueshëm) mbi letërsinë e tyne. E kemi thanë dhe e ripohojmë, se kompetencat e tij letrare janë të aq të vorfna, saqë i kanë damtue edhe rendin logjik të interpretimit, tue ndërtue pyetje joprofesionale apo deduksione të përçartuna. Nisë prej kësaj premise, dhe prej mosleximit të asnji vepre të Camajt, në mënyrë sistematike në shkrimin e tij (të Tares) asht pohue me habi sesi një mësues nga Prekali mundet me pasë progres akademik, a me përfitue bursa studimi. Madje kjo pyetje asht gati fobike, sikurse edhe statusi i refugjatit apo të emigrantit, pavarësisht kundërshtimeve të mavoshme të autorit Tare. Kjo gja, që asht pá edhe si e metë nga të tjerë, mund të argumentohet mirë e qartë me përgjigjen e Bardhyl Demirajt: *'Po ashtu, në bazë të të dhënave të arkivave shkencore universitare (LMU, Monacensia MuniH/ RFGJ), mund të mëtojmë pa rrudhur vetulla e mbyllur sy se Camaj e fitoi atë bursë me këllqet e veta.'*<sup>7</sup>

Në artikullin tonë, 'Kur mitet përfliten' patëm pohue në lidhje me shkrimin e z. Tares mbi mungesën e faksimileve e të *përshtatjes* (!) së njësive originale, tue ngritë në këtë mënyrë edhe një dyshim mbi autenticitetin e dokumenteve që citon vetë autori prej burimesh. Shembulli i një falsifikimi flagrant nga një dokument i CIA-s, nga z. Tare, vën në pikëpyetje jo vetëm seriozitetin e punës së tij, por edhe të autorëve të tjerë që e kanë mbështetë këtë punë, njëkohësisht edhe apoloji të e shpeshta të botuesit në rrjedhën e debatit aktual. Po e konkretizojmë ma tej. Në faqen 9 të shkrimit të z. Tares, asht një dokument i 3 janarit 1955, i cili segmentohet dhe transformohet si ma poshtë:

**Document Number (FOIA)/ESDN (CREST):**

CIA-RDP80-00810A005600130002-7

Release Decision: RIPPUB

Original Classification: S

Document Page Count: 4

Document Creation Date: January 3, 1955

Content Type: REPORT

\* .. General Dushan **Mugosha** in the UDB, are among the chief recruiters of Albanian agents who are sent into Albania.

(Dosja Tare, f. 9)

---

<sup>7</sup> *ibid.* Khs. edhe L. & A. Kola, 'Kur mitet përfliten': *'Kontaktet e tjera Camaj ('si refugjat'), nisë edhe prej statusit socio-politik të grues së tij të parë dhe familjes së saj (i ati i Ninës, ish-nënkryetari i Bashkisë së Beogradit), nuk duhet t'i ketë pasë të vështira me i sigurue. Diku ma poshtë në mënyrë kontradiktore e keni pranue edhe vetë, se fati i ka ndihë prej ish relatës bashkëshortore. Ndërsa çështjen e pozicionit të Universitetit e keni përthellue si lidhje rekrutuese, por nuk keni shtjellue letrën e Camajt drejtue Sheldisë. Konkretisht atë që pohon Camaj, se postin e tij në Universitet e ka sigurue me zotsi të vet. Këtë e keni anashkue pa / me dashje.'*

Ndërkohë, burimi autentik thotë ndryshe. Konsulto nënvizimin e maposhtën, nga ana jonë:

SECRET - U. S. OFFICIALS ONLY

25X1

- 2 -

5. Yugoslav clandestine activities against Albania have continued, at any rate until recently. Cedo Mijovic, Kapllan (fnu) and Vlado Popovic, who is a major in the UDB, are among the chief recruiters of Albanian agents who are sent into Albania. General Dushan Mugosha (member of the Communist Party, Serbia, Deputy in the Federal Parliament, and director of all immigrants) does not appear as one of the recruiters, although he directs these activities. He certainly wants to overthrow the present Tirana regime and substitute one under Yugoslav influence. But Mugosha has said that they must wait for the opportune moment.
6. The Yugoslav Government seeks, in a quiet way, a closer relationship with the National Committee for a Free Albania - NCFA, and with the Albanian emigrants in the West, in an effort to gain greater influence in this refugee community. The Yugoslav Government does not see the West as a trusted friend, with whom it can cooperate closely, and it fears the type of government the Anglo-Americans might introduce into Albania.
7. All Albanian political emigrants in Yugoslavia believed they were going to be sent back to Albania after the exchange of embassies. Mugosha issued a declaration that they would never do this, regardless of relations with Albania, and drew attention to Tito's declarations on the subject of normalization.<sup>2</sup>

Me sa rezulton, Tare falsifikon dokumentin simbas interesit argumentues. Formulimi që paraqet autori në fjalë nuk asht i saktë assesi, nisë gramatikalisht si fillim (*General Dushan Mugosha in the UDB, are (?) among...*) e mandej si faktim real. Dokumenti, të cilit i referohet vetë Tare dhe 'e citon', në pikën e tij 5—por tue e fshehtë këtë rast numërimin rendor dhe tue e paraprî nga një yllth—asht krejt ndryshe. Dokumenti i deklasifikuem i CIA-s dhe i aksesueshëm online (qysh nga 2007/11/01), thotë: '*Cedo Mijovic, Kapllan (fnu), dhe Vlado Popovic, i cili asht kryetari i UDB-s, janë ndër shefat rekrutues të agjentëve shqiptarë që dërgohen në Shqipëri. Gjeneral Dushan Mugosha (anëtar i Partisë Komuniste, Serbi, Deputet në Parlamentin Federal, dhe drejtues i të gjithë emigrantëve) nuk rezulton të jetë një ndër rekrutuesit, megjithëse ai i drejton këto aktivitete.*' Pra, simbas dokumentit Mugosha nuk asht kryetar i UDB-s dhe nuk i rekruton ai emigrantët shqiptarë si agjentë. Kështu që, ky dokument rrëzon sa dokumente të tjera, që në vetvete janë të papërputhshëm njëni me tjetrin. Prej këtu dalim tek çështja e relativizimit të interpretimit apo e statusit të tyne referencial (që simbas vetë kalsifikatorëve të CIA-s nuk konsiderohen si burime të aprovueme dhe të vërteta); e njëkohësisht dalim tek qëllimet e z. Tares, që disa analistë—krahas studiuesve—si Alfred Lela e Ermal Hasimja kanë parashtrure. Me këtë devijim nga e vërteta dokumentative, nuk mendojmë se shkrimi i z.

Tares ka vetëm deficite stilistikore, simbas Edon Qesarit,<sup>8</sup> por hedhë poshtë edhe formulimin konotativ të Ardian Vehbiut që ‘*Qasja publike ndaj figurave të mëdha të kulturës (por jo vetëm të kulturës) mbetet e ndarë më dysh: ose panegjirike, në kufi të histerisë adhurimtare; ose shkatërruese, në kufi të ikonoklazmës*’.<sup>9</sup> Reagimi masiv i shqiptarëve ndaj këtij debati, përjashto vektorët ‘krahinorë’ që disa duen të veshin—njejtë si ‘qasjen religjionale’ (e cila shpesh asht deformue, e jashtëkontekstualizue prej artikullit ‘Kur mitet përfliten’, apo edhe ba titull redaksional)—nuk mendojmë se asht shpehje e histerisë idoltare e i asnji elementi tjetër pejorativ, por asht burim i pavartetësisë dhe i arbitraritetit interpretimor të dosjes Tare, e cila ka pasë miratimin redaksional e botues, njëherësh. Debati asht në dinamikë e sipër, ende nuk janë konturue sinorët e tij, për me mbërritë në përcaktime të njanshme. Le t’i ftojme palët e treta (lexuesit) që në vend të ‘krahinizëm’, ‘partikularizëm’ dhe ‘religjion’ të shtojnë si fjalë kyçe edhe ‘kontestim’, ‘falsifikim’ dhe ‘diletantizëm’.

Nji ndër pikat, që z. Tare kapet si ‘i mbytuni për shkumë’, asht edhe Komiteti i Prizrenit. Intensivisht ripohohet, se Martin Camaj asht anëtar i KP, ndërkohë që z. Tare anashkalon citimin e plotë të një dokumenti të CIA-s [1954] i cili thotë: ‘*Çdo shqiptar, që arratiset në Jugosllavi asht i detyruem me iu bashkue Komitetit të Prizrenit. Në qoftë se ai refuzon këtë gja, ai nuk merr një kartë identiteti dhe as kartë racioni të ushqimeve dhe të rrobave. Në qoftë se ai asht mes moshës 15-60 ai vendoset në kamp përqendrimi, ku dajaku nuk asht se mungon. Në këtë rast gratë, fëmijët dhe të moshuemit, ata që refuzojnë të bashkohen lëhen në fatin e vet, pa ushqim dhe strehë. Kushdo, ndërkohë, që nuk dëshiron me vdekë prej mjerimit asht i detyruem t’i bashkohet Komitetit, ku krejt organizmi dhe drejtimi i saj, asht në dorën e oficerëve të UDB-së.*’ Krahaso:

---

<sup>8</sup> Khs. E. Qesari, ‘Camaj-Koliqi në mejdan’, *Peizazhe të fjalës*, 8 korrik 2020.

<sup>9</sup> A. Vehbiu, ‘Orientimi kritik’, *Peizazhe të fjalës*, 7 korrik 2020.

OUNTRY	Albania/Yugoslavia	REPORT	
SUBJECT	Albanian Refugees in Yugoslavia and the League of Albanian Refugees (Prizren Committee)	DATE DISTR.	26 February 1954
TYPE OF INFO.		NO. OF PAGES	5
DATE ACQUIRED		REQUIREMENT NO.	RD 25X1
		REFERENCES	

This is UNEVALUATED Information

THE SOURCE EVALUATIONS IN THIS REPORT ARE DEFINITIVE.  
THE APPRAISAL OF CONTENT IS TENTATIVE.  
(FOR KEY SEE REVERSE)

25X1

1. Every Albanian who flees to Yugoslavia is forced to join the Prizren Committee. If he refuses to do so he does not receive an identity card, nor food and clothing ration cards. If he is between the ages of 15 and 60 he is put in a concentration camp where use of the whip is not unknown. In the case of women, children, or old men, those who refuse to join are left to their own devices, without food and shelter. Anyone, therefore, who does not wish to die of hardships is forced to join the Committee whose entire organization and direction is in the hands of UDB officers.
2. The Committee takes its name from the city of Prizren in order to identify it with the patriotic movements emanating from the historic League founded in that Kosovo city in 1878. As a matter of fact, however, its main offices are located at Pristina.
3. Rights of the Albanian members of the Committee are limited to those of spying on each other. Its UDI (Yugoslav ID) officers use all available means, including bribery, threats, flattery, and torture in order to penetrate their Albanian charges thoroughly. Corruption has reached such a point as to seriously weaken the emigration and render it less effective for Yugoslav purposes than it would be if its morale were higher.

(CIA-RDP80-00810A003600930003-7, 2010/01/08, p. 1)

Me ç'rezulton, anëtarësia në KP asht e kushtëzuar qysh në krye. Pra, jo me vullnet vetjak. Kjo vlen për cilindo që arratisesh në ish-Jugosllavi, e mbase edhe për ata që ndërkohe (para krijimit të KP) gjendeshin në atë shtet. Ndërkaq, z. Tare, nuk konsideron as pikën 3 të këtij dokumenti, ku tregohen qartë mënyrat e torturimit të oficerëve të UDB-së ndaj shqiptarëve për me siguri informacione mbi situatën në Shqipëri, apo me krijue përçamje mes faktorit të emigrantëve politikë në ish-Jugosllavi, e ma gjanë. Për implikimin e Camajit në UDB, z. Tare nuk ka asnjë dokument real, përpos hamendsimeve dhe supozimeve se meqë të jesh anëtar i KP duhet me qenë detyrimisht spiun i UDB-së. Tue besue në artikulet e Tares 'se

nuk ka pasë asnjë qëllim me dengirue këto dy figura', pse nuk e ka konsiderue edhe pikën 12 të këtij dokumenti, e cila thotë: '*Refugjatët shqiptarë në Jugosllavi, nuk lejohen të bashkohen ose të shprehin simpati për grupe të tjera politike përveç Komitetit të Prizrenit. Me gjithë simpatizimet e përgjithshme politike, ndër refugjatët në Serbi dhe Mal të Zi, gjithsesi vetëm 5 % e tyre prej qytetit të Shkodrës dhe nënprefekturës, janë ithtarë të BKI, ndërsa 30 % e tyre prej Lumës dhe Dibrës, shkojnë mbas BKI-së. Të tjerët megjithëse jokomunistë, nuk kanë zgjedhë ndonjë drejtim politik. [...] Rinia në përgjithësi politikisht asht e pavendosun.'* Shih:

12. Albanian refugees in Yugoslavia are not permitted to join, or even express sympathy for political groups other than the Prizren Committee. Regarding general political sympathies among refugees in Serbia and Montenegro, however, only about 5% of those from Shkoder city and sub-prefecture are BKI followers, whereas about 30% of those from Luma and Dibra follow BKI.<sup>4</sup> The others, although not Communists, have not chosen any political banner. There are very few Balli Kombetar followers, and the Zogists are limited to those who held posts in Zog's State administration or in the army. Youth in general is politically bewildered.

(CIA-RDP80-00810A003600930003-7, 2010/01/08, p. 3)

Tash vijmë në një konkluzion: meqë Tare, me sa paraqet në këtë dosje, nuk ka asnjë dokument që e ban Martin Camajn agjent të UDB-së, pse nuk e ka konsiderue faktin se Camaj mund të ishte i targetuem si '*Non political banner*', pra apolitik, e që tue qenë edhe i ri, simbas vetë pohimit të dokumentit të CIA-s, mund të ishte politikisht i pavendosun? Pra, në këtë pikë, Tare asht sekuencial dhe 'i studion' faktet me partikularizëm, nëse do të huazonim terminologjinë e Vehbiut.

Pyetja tjetër, që e mundon Taren, asht se ku i merrte financat një i ri refugjat? Krahas nesh, edhe studiues të tjerë, dhanë arsytimin e tyre tue parakuptue edhe lidhjen me ish-gruen e Camajt, por mbi të gjitha si fryt i rezultatit të inteligjencës natyrore të vetë shkrimtarit e studiuesit (të ardhshëm).<sup>10</sup> 'Luksi' i Camajt, tashma bjen poshtë me kundërfaktet e dhana prej vetë dokumenteve, që disponohen deri tash apo edhe studiuesve ndërkohë. Pjesën e dok. të masipërm, në punimin e tij, z. Tare, e ka përkthye të pacunguem (shih f. 5):

---

<sup>10</sup> Khs. L & A. Kola, 'Kur mitet përliten': '*Për fatin tuej të keq, me burimet që keni në dispozicion, keni konfirmue se një malësor (ose me fjalët tueja një mësuesi nga Prekali) emigrant [f. 5, dok. 26 shkurt 1954], mundet me jetue falë statusit të tij si azilant dhe rezultave të tij nalta në Universitet. Pra, oficeri i UDB-së (e cila financonte jetesën e një azilanti si kudo tjetër sot një iks shtet) kontrollonte notat, dhe siguronte një jetesë aq sa. Njilloj si me benefitet qeveritare në vendet e ndryshme të botës, me rastin e pandemisë, kur përfitojnë edhe personat me status të ndryshëm social. Kështu që, koherenca e juej interpretuese asht e mangët.'*



11. Albanian students at the University of Belgrade are also subsidized and directed by UDB. A UDB officer checks on their grades after examinations, and those who display the greatest zeal are given money rewards and the possibility of making tours to Dalmatia or to Zagreb.

(CIA-RDP80-00810A003600930003-7, 2010/01/08, p. 3)

Por interpretimi asht në sajë të interesit dhe kandvështrimit të njanshëm, që e ban një gja të tillë kundërshtuese me raportimet e CIA-s. Dokumenti thotë qartë, se shpërblimi asht marrë si student i dalluem! Edhe karriera e tij akademike, e mavonshme, e ndriçon këtë fakt. Edhe, qasja dedektive e punësimit të Camajt në Radio Beograd (që me sa duket asht e kontestueshme),<sup>11</sup> së bashku me ‘infiltrimet’ e hamendsueme, tashma ka marrë një përgjigje të duhun në debat, saqë e ka ba botuesin Vehbiu, me u ripozicionue: *‘Angazhimi i tij politik (i M.C., shën. ynë), në Komitetin e Prizrenit dhe në Radio Beogradi mbase duhet parë si pjesë e përpjekjeve të tij për të mbijetuar, në një mjedis sa të huaj, aq edhe armiqësor.’*<sup>12</sup> Në këtë linjë logjike, tue pasë mbështetjen e vetë botuesit të masipërm, pse nuk mund të mendohet se punësimi i Camajt në RB, nëse ka ndodhë ndonjiherë, asht ba për mbijetesë, i detyruem me ba edhe një a ma shumë punë, jo domosdo të lidhuna me UDB-në? Nëse do të ishte informator a agjent, siç aludon Tare, pse duhej të bante punë të tjera Martin Camaj? Por, vetë dokumenti i CIA-s, e zbardhë statusin ekonomik e social të emigrantëve shqiptarë-politikë në ish-Jugosllavi: *‘ndihmat ekonomike jugosllave, të cilat ata marrin janë krejtësisht të pamjaftueshme, për nevojat bazike të tyre. Jugosllavët shfaqin haptas një shkallë të konsiderueshme simpatie në lidhje me ta, por faktikisht nuk iu besojnë këtyne njerëzve, dhe i mbajnë nën mbikqyrje të vazhdueshme’*. Krahaso:

...oslav subsidies which they receive are totally inadequate for their basic necessities. The Yugoslavs openly display a considerable degree of sympathy in their regard, but actually they do not trust them and keep them under close surveillance. Nikoll Gjoni

(CIA-RDP80-00810A003600930003-7, 2010/01/08, p. 4/23)

Pra, nisë nga pohimi i fundit i dok. të CIA-s, shpjegohet edhe lëvizja në Romë e M. Camajt. Së pari, të ishte agjent i UDB-së nuk do të lëvizte nga Beogradi, pavarësisht teorive konspirative se ishte nisë me mision. Së dyti,

---

<sup>11</sup> Shtojmë këtu pohimin e B. Demirajt: *‘I sigurt është vetëm punësimi i së shoqes në atë institucion, të cilën gojë të liga vijojnë ta “damkosin” si serbe dhe si e bija e ish-nënkryetarit të Bashkisë së Beogradit. Le ta mësojë edhe z. Tare se nëna e saj ishte me origjinë shqiptare, andaj e njihite dhe e studionte gjuhën e nënës njëlloj si Martini.’* (Pan., ibid.)

<sup>12</sup> Ardian Vehbiu, ‘Bashkë apo veç?’, *Peizazhe të fjalës*, 11 korrik 2020.

atmosfera e vështirë e statusit të azilantit politik, e ka ba që me gjetë rrugën e largimit. Së treti, aspiratat për investim intelektual në qytete ma të mëdhaja se Beogradi, kanë ndërtue gravitetin e vet. Katedra Albanologjike në Myhih, e dëshmon këtë. Largimi prej Beogradit, nuk ishte i mundshëm me u krye qysh në fillim (1948, kur Camaj u arratis nga Shqipnia), sepse kushtet politike nuk ishin pjekë, sa me sigurie një largim pa pasoja përkatëse. Eksperienat me personalitete të tjera shqiptare e dëshmojnë këtë gja; pra qëndrimi në ish-Jugosllavi, dhe po prej këtej tranziti. Po kështu frika ishte e madhe, se hipotezat e përmirësimit të raporteve (me ndërmjetsimin e BS) mes Titos e Enverit, mund të sillnin fatalitet në grupacionin e emigrantëve politikë. Konkretisht, dorëzimin e tyre në organet shqiptare komuniste:

feel that sooner or later they will be consigned to Albania's new Communist authorities under Yugoslav sponsorship. This fear was particularly evident among the 300 Albanian delegates to the Prizren Committee's last annual assembly when in an address by Dusan Mugosa he said: "The report has reached me that you have become the victims of apprehension following the recent evolution of our foreign policy towards the Soviet Union and the Popular Democratic countries. I can assure you, for President Tito as well as for myself that however that phase of policy develops, no refugee will be harmed by it because each will be given the choice of emigrating wherever he wishes or of remaining in Yugoslavia with full rights of citizenship."

(CIA-RDP80-00810A003600930003-7, 2010/01/08, p. 2/5)<sup>13</sup>

Diplomacisë së Mugoshës nuk asht se i besohej, prandej edhe shqiptarët ishin skeptikë. Dhe me të drejtë konteksti historik na tregon, se jugosllavët kishin mbjellë frikë e persekutim në komunitetin e emigrantëve (shqiptarë) politikë. Arratisja prej në Beograd, në rastin e Camajt, nuk ishte aq e thjeshtë, sa paramendon Tare. Kujtojmë këtu shembullin e vitit 1951, kur refugjatët u pyetën prej ish-Jugosllavisë se nëse donin të emigronin dhe në çfarë vendesh. Kjo lëvizje, siç raporton CIA, ishte një kurth sepse ata që kishin shprehë dëshirën me lanë Jugosllavinë, u arrestuen fill mbrapa dhe u internuen ose u burgosën, e u banë viktima të krejt persekutimeve të mundshme:

---

<sup>13</sup> 'Refugjatët e ndiejnë se heret a vonë, do të dorëzohen tek Autoritetet e partisë së re Komuniste nën mbështetjen e jugosllavëve. Kjo frikë ishte veçanërisht e dukshme ndër 300 delegatë shqiptarë, tek Asambleja e fundit e përvitshme e Komitetit të Prizrenit, kur në fjalimin e tij Dushan Mugosha, tha: "Më ka ardhë një raport se ju jeni ba viktima të ankthit që po pason zhvillimet e fundit, të punëve tona të jashtme, me Bashkimin Sovjetik dhe me vendet Popullore Demokratike. Unë ju siguroj ju, si prej Presidentit Tito si prej meje, se sido që të marrin punët, asnjë refugjat nuk do të damtohet nga kjo gja, për shkak se secilit ka me iu dhanë mundsia e zgjedhjes, për me emigrue ku të dojë, ose me qëndrue në Jugosllavi si shtetas me të drejta të plota.'"

20. In 1951 all refugees were asked by the Yugoslavs whether they wished to emigrate, and if so, to indicate to which countries. The move was a trap because those who had expressed a desire to leave Yugoslavia were shortly thereafter arrested and interned or imprisoned, and made the victims of all sorts of persecution.
21. In 1951 and again in 1952 a group of [ ] journalists toured all the centers sheltering Albanian refugees. The journalists interviewed many refugees, who desired to explain their true situation and that of their compatriots, but did not dare to do so because of reprisals, chiefly beatings meted out to others who showed greater temerity.
22. The recent arrest of Ndue Bajraktari and his comrades, guilty of having planned to flee to [ ] in order to escape being forced to take part in operational sorties into their country, has created a great impression among refugees.

(CIA-RDP80-00810A003600930003-7, 2010/01/08, p. 4)

Pra, asht e pakontestueshme se historitë e arratisjeve (nga shqiptarët) prej ish-Jugosllavisë, nuk kanë qenë të lehta. Në një kontekst të tillë historik, qëndrimi ishte prurëndë taktike, jo detyrimisht kolaboracionizëm me UDB-në, siç pretendon z. Tare me e paraqitë. Sikur Camaj të largohej ma heret, shtye edhe prej dëshirës së mbrendshme, do të kishte pasë fatin e Ndue Bajraktarit e shumë të tjerëve. Ky fakt, e shumë fakte të tjera, kallëzojnë se Tare nuk asht objektiv në paraqitjen e bazës arkivore, por as në interpretimin e historisë. Kjo gja ka ba me pohue: *‘se ai nuk zotëron dhe nuk njeh rregullën bazë të leximit të dokumentit si burim parësor, shqyrtimin me sy kritik të tij, si dhe nuk e ka të qartë, se një studiues kur merret me dokumentin, ka në vetëdijen e tij disa pyetje bazore të gatshme, që i bën vetes për të qenë profesionalisht korrekt në analizë.’*<sup>14</sup>

Pikë tjetër e kritikueshme, në shkrimin e z. Tares, asht mënyra si kërkon me i thjeshtue disa fakte historike, që lidhen me fatin e largimit nga ish-Jugosllavia, tue dashtë me implikue shtetet ndërmjetsuese si rekrutuese të personaliteteve shqiptare. Një shembull i tillë abuzimi, asht ba dhe me një letër të M. Camajt dërgue dom Lazër Sheldisë.<sup>15</sup> Mes tjerash: *‘Keni ngritë e faturue hipoteza qoftë edhe kur emni i Camajt nuk asht i shfaqun fare në njisinë dokumentative. Ky, asht spekulacion i pastër diletant. E sa e sa probleme të tjera, që*

<sup>14</sup> R. Gurakuqi, *Mapo, ibid.*

<sup>15</sup> Khs. L. & A. Kola, *ibid.*: *‘Që Camaj ka pohue në letër se Sigurimi ka gisht, nuk asht ndonji çudi e madhe i nderti z. Tare. Ngjani shumë infantil në pohimin tuej [f. 35] “të duket shumë e çuditshme, që një prift katolik i larguar shumë herët me aktivitet fetar në Amerikën Latine dhe me një aktivitet periferik në emigracionin e New Yorkut, të vritej nga Shërbimi Sekret Shqiptar. Aq më shumë në fundit e vitit 1988 ku Shërbimi inteligjent nuk kishte as motiv dhe as mundësi për të bërë një atentat të tillë ndaj dikujt që nuk kishte aktivitet të dukshëm kundër regjimit”. Vetëm një vit ma parë (1987) agjuntura shqiptare, me sa përfliut, eliminoi Aleksandër Kondon. Pra, ishte e mundshme me krye shërbesa në favor të Tiranës zyrtare.’*

vetëm mbesin pyetje pa përgjigje. Këto pyetje duhet t'i jepnit ju ma së parit, sepse keni pasë mirësinë me prû një diskutim të tillë në fushën e traditës shqipe, dhe të asaj që quhet trashëgimi jashtë kontureve socrealiste.’<sup>16</sup>

Pyetjet që parashtron Tare, janë kryesisht të natyrës, se ‘pse i interesonte shërbimeve sekrete amerikane fati i Camajt’? Fillimisht, mbështetë në arkivat e vetë CIA-s, ekzistonin dy parakushte: 1) ‘nji opinion i përgjithshëm i shqiptarëve refugjatë në Jugosllavi, se shpëtimi i Shqipnisë vjen vetëm prej Perëndimit’ dhe 2) se shqiptarët, që ishin refugjatë në krye të herës në Mal të Zi (zakonisht prej zonave të Dukagjinit, Lezhës, Malësisë së Madhe dhe Shkodrës), besonin ngultas në ndërhyrjen çlirimtare të Perëndimit:

13. The general opinion of Albanian refugees in Yugoslavia is that Albania's salvation can come only from the West. Another general opinion there seems to be that no basic change can take place in Albania without another world war. 25X1
14. Mark Pashko, currently leader of the Montenegro group of refugees [redacted] is one of BKI's strongest supporters. He holds that his country's liberation can come only from the West, and that its best representatives there are the leaders of BKI. 25X1

(CIA-RDP80-00810A003600930003-7, 2010/01/08, p. 3)

Domethanë, Camaj, si target komunitar-refugjatësh (shqiptar prej Dukagjinit), besonte në intervenimin e huej perëndimor, tue u nisë prej vetë fateve të miqve të tij, si dom Lazër Sheldija. Z. Tare, askund nuk ka integruë, nji burim të njohun historik, se vetë Sheldija ka ikë prej ish-Jugosllavisë nëpërmjet ndërhyrjes së Austrisë. *Albanian Catholic Bulletin*, dëshmon: ‘*Sheldija continued his education at the University of Belgrade, and in 1954 was allowed to leave the country, thanks to the intercession of the Austrian government* [Sheldija e vijoi shkollimin e tij në Universitetin e Beogradit, dhe në 1954 u lejue me lanë vendin, falë ndërhyrjes së qeverisë austriake]’.<sup>17</sup> Me ç’duket lidhja logjike e historike, asht jo aq konspirative seç e jep z. Tare. Sa i takon, përfshimjes në agjuntura sekrete amerikane të Camajt, sërish, ai nuk ka dhanë asnji dokument konkret. Nëse, sikurse po pretendon së fundmi vetë Tare, ai nuk mban asnji pozicion historik (edhe pse e ban sa herash), le t’i kishte paraqitë shqiptarëve me bujari dosjet integrale, pa dhanë komentime e aludime, e secili kishte mujtë me pasë nji receptim vetjak. Por, pozicionimi me kriter devijimin faktik të bazës arkivore, ka sjellë dhe dështimin e tij, përkrah apologjive të rastit, nga disa persona, përmendë edhe ma nalt, nji analist si Andi Bushati, dhe ma së shumti nga individë anonimë që formulojnë opinione në rrjetet sociale.

<sup>16</sup> L. & A. Kola, *ibid.*

<sup>17</sup> ACB, 1989, vol. X, p. 171.

Mbërritja në Romë, nga ana e Martin Camajt, përmes aludimeve (edhe) me anë të rekrutimeve të Ernest Koliqit, për favor të një iks apo epsilon agjente ngajnë ende metodikë e dobët arsytuese, nga autori Tare. Asht pa vend me shënue sërish peshën dhe autoritetin e Koliqit, i cili në kushtet e veta historike-politike, ka shërbye mbi bazën e qëllimeve nacionaliste, me të mirat e me të këqijat e veta, sikur e pranon vetë ai. Nji përlyemje e tij, si etiketim fashist (tue e marrë fashizmin gjithnji si finalitet politik), asht e njejtë si ajo e Regjencës me Át Anton Harapin, i cili siç pohon ‘*nuk mujt me e pa Shqipnín n’anarki*’.<sup>18</sup> E ngjanë, se disa pikëpamje regresive po riaktivizohen si në kohën e enverizmit. Harapi, u drejtohej komunistëve (13.I.1944): ‘*gadi të gjithë komunistat shqiptarë veprojnë me krye në thes pa dijtë shka bajnë dhe për shka veprojnë. Por, po thonë se e kanë per Shqipni, e vetëm per Shqipni. Unë due t’u besoj, por ky dallim midis doktrinës komuniste dhe veprës komuniste me formën kombtare – sikurse i kam ndigjue unë dhe vetë tue dishmue organizatorët komuniste – mue më ban me dyshue për sinqeritetin e kësaj rrymë Shqiptare.*’<sup>19</sup> Kështu, lancimi i këtij debati publik me përmasa kombtare (jo i advokuem në rrjete sociale, siç kërkojnë ta impostojnë disa, si Primo Shllaku, por në shtyp [atë të shkruem dhe atë elektronik] e media televizive), na ban *me dyshue për sinqeritetin* e këtij debati. Debati asht i mirëpritun, kur dosja të mos ketë shartime dhe falsifikime dhe të ketë neutralitet në objeksionin historik, prandej kanë reague masivisht shqiptarët, sepse po të konsiderojmë në kontekst tjetër, nji ndër mbylljet e Vehbiut: ‘*autorë si Koliqi dhe Camaj, pavarësisht prejardhjes së tyre dhe identitetit të tyre partikular, ... shihen dhe ... trajtohen si të gjithë shqiptarëve.*’<sup>20</sup>

Ndërhymjet e Koliqit, si në rastin e Norbert Jokl-it, kur ishte Ministër Arsimi, apo i Petro Markos në nji rast tjetër janë shprehje e humanitetit si princip, pa marrë parasysh kurrfarë ngjyrese politike natyrisht. Për humanitetin e njeriut, nuk asht e udhës me dyshue askush e me gjetë vjegza kompromentimi. Asistenca e Koliqit, në shumë dimensione, ndaj bashkadhtetarëve dhe emigrantëve politikë duhej të mbrohej me ligj në Shqipni, dhe jo me pasë zbirilime afaktike. Në botën demokratike, aktet humanitare janë vlerë kulturore, e askush sot as mot nuk e akuzon Miep Gies si tradhtarë, e cila ka shpëtue *Ditarin e Anne Frank* ose ka mundsue fshehjen e familjes së saj për nji kohë të caktueme. Pra, kahet politike-racia

---

<sup>18</sup> Át Anton Harapi, *Naltimi i ndërgjegjes kombtare*, BF, Shkodër, 2017, f. 405.

<sup>19</sup> *ibid.*, f. 406.

<sup>20</sup> A. Vehbiu, ‘*Bashkë...*’, *ibid.*

neutralizohen para gjestit fisnik. Madje në rastin e Gies, krahas akordimeve të shumta në nder të saj, qysh në 1972 ‘minor planet 99949’ mban emnin e saj. Por, në kulturën shqipe riciklimi kulturor i frymës komuniste, kinse me ridimensionue apo ndriçue figurat letrare a historike të Shqipnisë, konsiderohet si ‘progres social’. E këtë duen me e ba me z. Taren, i cili as emnat e Pader Daniel Gjeçajt e të Prek Calit nuk din me i thanë në rregull. Tash na lypet me qenë ma seriozë. Debati pranohet, kur ofron korrektësi. Nëse dosjet e secilit shkrimtar shqiptar, zërthehen me saktësi shkencore e rigorozitet, dhe ata gjenden të implikuem apo kolaboracionistë në dam kombtar, besojmë se Shqipnia ka me e gjetë rrugën e pranimt të tyne, sikurse e kanë gjetë kultura të tjera. Shqipnia ka kapërcye problemet e komunizmit, edhe kur vepra e disa shkrimtarëve shqiptarë asht në thelb komuniste [krahas funksioneve të tyne politike në ish-regjimin totalitar], e jo ma me Camajn e Koliqin, që kanë një vepër antikomuniste e anti-socrealiste. Publiku shqiptar nuk i druhet aspak se ku ka me e çue debati i sotëm veprën letrare të Ernest Koliqit apo të Martin Camajt, por publiku nuk mund të pranojë aspak qëllimin jashtëkombtar, sado ‘folklorizëm’ mund t’i duket ndonji ‘buzëholli’. Prandej, del se punimi i z. Tares, sa i takon investigimit mbi dosjen Camaj, deri më tash, asht i kontestueshëm, nisë prej vetë titullares së AIDSSH, Sula, e cila për sa raportojnë mediat ka ba sqarimin për dosjen Camaj: *‘Dosja është deklasifikuar vitin e kaluar në janar. Nuk bëhet fjalë për dosje bashkëpunimi, por për një fashikull pune. Subjekti është 2A, që do të thotë se ishte bërë gati për arrest. Dosja ka 22 faqe. Duhet lexuar me shumë kujdes. Martin Camaj ka qenë shumë inteligjent, ka pasur një shkollim të mirë. Sigurimi është përpjekur t’i vrasë moralisht. E thashë edhe njëherë që është dosje survejimi. Duhet të kuptojmë që një dokument sigurimi është një dokument i një policie politike, militare, e cila funksiononte mbi ligjin. Një policie që ka pasur jetën e njerëzve në dorë. Ka pasur një qëllim. Qëllimi ka qenë përpunimi. Një dokument nuk tregon kush është personi.’*<sup>21</sup> Nji mbështetje të tillë, e ka dhanë dhe Gurakuqi, në artikullin e cituem tashma. Se ç’të reja ka me prû z. Tare, në favor të një sprove të rrumujshme dhe ngarkue me aludime, po presim.

Sa i takon analizës mbi Koliqin, ngjanë se autori paraqet konfuzitet në drejtleximn e materialeve që disponon, dhe merr si të mirëqena deponimet në raportet e CIA-s. Me fjalë të tjera, ‘lojën e telefonit të prishun’ e ka interpretue si mesazh të pastër, pa e ditë se dokumentet informative, kur ndërlihdhen disa persona njiherësh, duhet të shihen me rezerva në tanësinë

---

<sup>21</sup> Khs. *dosja.al*.

e vet. Edhe qasja ndaj Koliqit, ka gjetë kontestim nga specialistë të fushës, të cilët nëpërmes vetë Hass-it (që Tare e qënderzon si protagonist të narrativës mbi Koliqin) dhe agjenturës së tij të dy a ma shumëfishtë, i ban konkludimet e shkrimit të qortueshme. Keqleximi apo mënyra sesi janë paraqitë disa njisi, që për publikun nuk janë as faksimile, përbajnë edhe pohime të paprovueme sikur: *‘Nuk ka asnjë dyshim se Koliqi ishte në qendër të një aktiviteti të rëndësishëm spiunazhi në Romë. Si informator i tri shërbimeve sekrete, si rekrutues si dhe kontribuues i materialeve me interes, të cilat i kaloheshin KGB-së sovjetike të paktën nga dy burime: Karl Hass dhe Alois EDER.’* (Tare, f. 23). Se cilat janë këto tri shërbime sekrete, që e faktojnë përfshimjen e Koliqit ndër agjuntura, ende nuk u mësue në dosje. Me sa rezulton, çdo interpretim asht i palëve të dyta a ma tepër, jo drejtpërdrejt nga Koliqi. Kjo gja nuk përban akuzim as implikim. Nji interpretim gjysmak, dhe i orientuem ‘kah don vetë’, nuk mund t’u sillet shqiptarëve si nismë e pastër transparence, paçka receptimit sensacional [në media/publik] që dy nga pilastrat e ekzilit shqiptar ish-in (?) spiunë të disa agjencive sekrete.

Mungesat e referencave nga faqja në faqe, shpeshohen dhe kjo sjellë edhe nji çorientim të autorit, tue citue mandej edhe burime terciiale (shkëputë nga dosja Camaj, rimarrë nga nji raport i 1958). Me këtë rast, në f. 25, Tares fillon e i ngatërrohet filmi pak; nji person që referon Gjon Gjinaj, ma poshtë i del Gjin Gjoni. Çka asht ma e randësishmja, z. Tare, ***nuk ka burime të verifikueshme*** për implikimin as të njenit e asaj të tjetrit autor. Pra as të Camajt, as të Koliqit. As sa kanë marrë, as sa janë pague, për kê a si. Dokumente të tjera, që sot edhe në arkivistikën shqipe përbajnë fakticitetin e nevojshëm, mungojnë. Nuk mund të ndërtohet hipotezë me aludime dhe me fantazi, në lamin historik. Evidencat e cingueme, mosfaksimilet, citimet jashtëkontekstuale, shartimet apo falsifikimet nuk mund të jenë punë e vlerësueshme mbi asnji autor a figurë shqiptare, mbrenda apo jashtë vendit.

Shpresojmë që në vijim, z. Tare të jetë ma i vëmendshëm në vërtetësinë e verifikueshme dhe që të konsultohet ma shumë me redaksinë, ku do të botojë, por edhe të ketë parasysh se oponenca e receptuesit serioz asht e pranishme, përtej ‘gallatave’ në komente rrjetesh sociale.

Ann Arbor, Michigan  
12 korrik 2020.